

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve

Fund 1

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

## Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	
Pasqyra e pasurive neto e Fondit 1	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	2
Pasqyra e ndryshimeve në pasuritë neto të Fondit 1	3
Treguesit financiarë të njësisve llogaritëse	4
Pasqyra e njësisve llogaritëse	5
Shënimet për pasqyrat financiare	6-25

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Anëtarët dhe menaxhmentin e “Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a”

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “**Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve Sh.a - Fondi 1** (*“Fondi 1”*), të cilat përbëhen nga pasqyra e pasurive neto të Fondit 1, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në pasuritë neto të Fondit 1, treguesit financiar të njësisë llogaritëse, pasqyra e njësisë llogaritëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Fondit 1 paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të fondit 1 më 31 Dhjetor 2017 dhe performancën e tij financiare për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Bazat për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit tonë për përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Etikës të Kontabilistëve për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

### Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Fondit 1 për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 u audituan nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion të pa ndryshuar për ato deklarata në mars 2017.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisje për Pasqyrat Financiare**  
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e raporteve financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë që të vazhdojë aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet e lidhura me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Kompaninë ose të ndërprejë operacionet, ose nuk ka alternative reale tjetër përpos ta bëjë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

## Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë raportin e auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancie që një auditim i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një pasaktësi materiale, nëse ekziston. Pasaktësitë mund të lindin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato pritet të ndikojnë tek përdoruesit në vendimet ekonomike të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa ai që rrjedh nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël, dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim mbi përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të dëshmive të auditimit të siguruar, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë së Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në dëshmitë e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditorit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmën mund të shkaktojnë ndërprerjen e parimit të vijimësisë së Kompanisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në një mënyrë që të arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë, në mes të tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Kosova sh.p.k.*

Deloitte Kosova sh.p.k.  
Shkurt 21, 2018


*Ky raport është përkthim i versionit origjinal në gjuhën angleze, në rast mospërputhjeje midis këtyre dy raporteve, raporti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.*



**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1**  
**PASQYRA E PASURIVE NETO TE FONDIT 1**  
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017  
 (vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
<b>Pasuritë</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5	162,531	66,854
Investimet në dispozicion për shitje	6	6,621,550	6,230,200
Investimet e mbajtura deri në maturim	7	230,927	190,308
Të arkëtueshmet tjera		2,290	3,328
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>7,017,298</b>	<b>6,490,690</b>
<b>Detyrimet dhe fondet e pjesëmarrësve</b>			
<b>Detyrimet</b>			
Detyrimet për tarifën e menaxhimit		10,748	9,716
Detyrimet për ndarjen e fitimit	8	77,653	-
Detyrimet tjera		7,197	995
		<b>95,598</b>	<b>10,711</b>
<b>Fondet e pjesëmarrësve dhe rezervat teknike</b>			
Pasuritë neto të Fondit 1		6,631,892	5,953,101
Teprica për vitin		289,808	526,878
<b>Gjithsej fondet e pjesëmarrësve</b>		<b>6,921,700</b>	<b>6,479,979</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe fondet e pjesëmarrësve</b>		<b>7,017,298</b>	<b>6,490,690</b>
<b>Njësitë e llogaritjes të emetuara</b>			
Vlera e njësisë së llogaritjes		41,822.98	40,901.01
		<b>165.4999</b>	<b>158.4308</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve – Fondi 1 më 21 shkurt 2018 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga

  
 Z. Bajram Bajrami,  
 Drejtor menaxhues

Pasqyrat e pasurive neto të Fondit 1 duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 25, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1**  
**PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE TE FONDIT 1**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

	Shënimet	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<b>Të ardhurat</b>			
Të ardhurat nga interesi	9	80,885	114,496
Të ardhurat e realizuara nga shitja/maturimi i investimeve	10	47,396	24,669
Të ardhurat nga dividenda		79,856	61,157
Të ardhurat nga këmbimi valuator i artikujve monetar		6,907	3,753
Të ardhurat tjera		-	-
<b>Gjithsej</b>		<b>215,044</b>	<b>204,075</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Tarifa e menaxhmentit		(101,879)	(89,775)
Shpenzimet për ndarjen e fitimit	8	(77,653)	(45,779)
Tarifa e provizionit dhe transaksioneve		(28,796)	(22,416)
Humbjet e realizuara nga investimet		(18,098)	(10,096)
Humbja nga këmbimi valuator i artikujve monetarë		(12,313)	(9,793)
<b>Gjithsej</b>		<b>(238,739)</b>	<b>(177,859)</b>
<b>Neto të ardhurat nga investimet</b>		<b>(23,695)</b>	<b>26,216</b>
<b>Të ardhurat e porealizuara</b>			
Fitimet e porealizuara nga letrat me vlerë në dispozicion për shitje, neto		600,173	415,170
Ndryshimet në këmbimin valutor të investimeve në investime		(286,670)	85,492
<b>Gjithsej</b>		<b>313,503</b>	<b>500,662</b>
<b>Teprica neto e Fondit 1 për vitin</b>		<b>289,808</b>	<b>526,878</b>

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve neto të Fondit 1 duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 25, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1**  
**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË PASURITË NETO TË FONDIT 1**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

Shënimet	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Fitimi neto nga investimet	(23,695)	26,216
Fitimet e përealizuara	313,503	500,662
<b>Teprica neto e Fondit 1 për vitin</b>	<b><u>289,808</u></b>	<b><u>526,878</u></b>
Kontributet e marra nga Pjesëmarrësit	487,436	481,785
Pensionet e paguara	(335,523)	(166,308)
<b>Rritja nga njësitë e faturimit</b>	<b><u>151,913</u></b>	<b><u>315,477</u></b>
<b>Gjithsej rritja në pasuritë neto</b>	<b><u>441,721</u></b>	<b><u>842,355</u></b>
Pasuritë neto më 1 janar	6,479,979	5,637,624
<b>Pasuritë neto më 31 dhjetor</b>	<b><u>6,921,700</u></b>	<b><u>6,479,979</u></b>

Pasqyra e ndryshimeve në pasuritë neto të Fondit 1 duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 25, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI 1**  
**TREGUESIT FINANCIARË TË NJËSIVE LLOGARITËSE**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017**  
*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

---

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Njësitë llogaritëse në fillim të vitit	40,901	38,791
Vlera e njësive llogaritëse në fillim të vitit	158	145
Pasuritë neto të fondit të pensioneve në fund të vitit	6,921,700	6,479,979
Numri i njësive llogaritëse në fund të vitit	41,823	40,901
<b>Vlera e njësive llogaritëse në fund të vitit</b>	<b>165</b>	<b>158</b>

Treguesit financiarë të njësive llogaritëse të Fondi 1 duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 25, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare.



**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI  
PASQYRA E NJESIVE LLOGARITESE TE FONDIT 1**  
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017  
*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

<b>Përshkrimi</b>	<b>Numri i njësive të llogaritjes</b>	<b>Vlera e pasurive neto</b>
Njësitë llogaritëse në fillim të vitit	40,901	6,479,978
Njësitë llogaritëse të emetuara gjatë vitit - kontributet	2,974	487,437
Njësitë llogaritëse të emetuara gjatë vitit – transferet në fondet tjera	(13)	(2,142)
Reduktimi i njësive llogaritës për shkak të transfereve në Fondi 2	(1,550)	(253,013)
Reduktimi i njësive llogaritës për shkak të pagesave të benefiteve	(489)	(80,368)
Reduktimi i njësive llogaritës për shkak të pagesës së tarifës nga pasuritë neto të Fondi 1	-	-
Rritja neto nga operacionet	-	289,808
<b>Gjithsej numri i njësive llogaritëse në fund të vitit</b>	<b>41,823</b>	<b>6,921,700</b>
<b>Vlera e njësisë së llogaritjes</b>		
Në fillim të vitit	158	
<b>Në fund të vitit</b>	<b>165</b>	

Pasqyra e njësive llogaritëse të Fondi 1 duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 25, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

## **1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tej referuar si "Kompania" ose "FSKP") është themeluar si shoqëri aksionare më 29 gusht 2006 me numër të regjistrimit të biznesit 70378739. Kompania ka filluar operimin e saj që nga data 04 shtator 2006. Kompania gjendet në Rr.UCK, nr. 50/2, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Ligji nr. 05/L-116; 2012/04-L-168; 04-L-115, 2011/04-L-101; 03/L-084; për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/20 mbi pensionet në Kosovë nën të cilin është themeluar Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve – Fondi 1, parashikon mbi programin suplementar e kursimeve pensionale, të themeluar nga kontributet pensionale të të punësuarit dhe punëdhënësit. Secili pjesmarrës vullnetar ka Llogarinë Individuale në Fondin 1, në të cilën kreditohen kontributet.

Fondi 1 administrohet dhe menaxhohet nga Kompania – FSKP. Aksionarët kryesorë të Kompanisë janë Prva Group PLC, Slovenia dhe Korporata Dukagjini, Republika e Kosovës.

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

Politikat themelore të kontabilitetit të cilat janë adaptuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e prezentuara, përveç nëse caktohet ndryshe.

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhshmëri me rregullat dhe rregulloret e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të cilat janë të bazuara në njohjen dhe matjen e kriterëve të Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

### **2.2 Bazat e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bayë të parimit të vijimësisë.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur politikat e rëndësishme kontabël dhe bazat e matjes të përmbledhura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse caktohet ndryshe.

Këto pasqyra financiare duhet të lexohen ashtu siç janë përgatitur në përputhshmëri me standardet dhe rregulloret kontabël. Gjithashtu, kërkon që menaxhmenti të vlerësojë procesin e zbatimit të politikave kontabël.

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro, monedha e Bashkimit Evropian.

### **2.3 Standardet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Ndryshimet e reja në vijim të standardeve ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë efektive për periudhën raportuese aktuale:

- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e rrjedhës së parasë"** - Iniciativa për shpalosjet (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017),
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat"** - njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuara (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017)
- **Ndryshimet në SNRF 12 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim për heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (Ndryshimi i SNRF 12 që do të aplikohen për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017).

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI  
SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1  
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017**  
*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

---

Adaptimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka rezultuar në ndonjë ndryshim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

**2.4. Standarde dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive**

Standardet dhe interpretimet e lëshuara, por që ende nuk kanë hyrë në fuqi, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të bankës janë diskutuar më poshtë. Shoqëria synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

Në korrik 2014, BSNK publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 Instrumentat Financiarë që zëvendëson SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet e mëparshme. SNRF 9 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, me aplikim të hershëm të lejuar.

- **SNRF 9 Instrumentat Financiare**

**Klasifikimi - Pasuritë financiare:**

SNRF 9 përmban një metodë të re klasifikimi dhe matjeje për pasuritë financiare që pasqyrojnë modelin e biznesit në të cilin menaxhohen asetet dhe karakteristikat e tyre të rrjedhës së parasë.

SNRF 9 përfshin tre kategori kryesore të klasifikimit për pasuritë financiare: të matura me koston e amortizuar, FVOCI dhe FVTPL. Ajo eliminon kategoritë ekzistuese të SNK 39 që mbahen në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe në dispozicion për shitje.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKVE TE RËNDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)

2.4. *Standarde dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive (vazhdim)*

• SNRF 9 Instrumentat Financiare (vazhdim)

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në FVTPL:

— ajo mbahet brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit është mbajtja e mjeteve për të mbledhur rrjedha kontraktuale të parave; dhe

— kushtet e saj kontraktuale sjellin në datat e specifikuar rrjedhat e parave të cilat janë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (SPPI) në shumën kryesore të paguar.

Një pasuri financiare matet në FVOCI vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktuar si në FVTPL:

— ajo mbahet brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit arrihet si nga mbledhja e rrjedhave të parave kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare; dhe

— kushtet e saj kontraktuale sjellin në datat e specifikuar rrjedhat e parave të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të paguar.

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për tregtim, Kompania mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në OCI. Këto zgjedhje bëhen në bazë investimi.

Të gjitha pasuritë financiare që nuk klasifikohen si të matura me koston e amortizuar ose FVOCI siç përshkruhen më lart, maten në FVTPL. Përveç kësaj, në njohjen fillestare, Kompania mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një pasuri financiare që plotëson kërkesat e tjera për t'u matur me koston e amortizuar ose në FVOCI si në FVTPL nëse bën kështu eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje kontabël që do të lindte ndryshe. Një pasuri financiare klasifikohet në një nga këto kategori në njohjen fillestare.

**Vlerësimi I ndikimit**

Standardi do të ndikojë në klasifikimin dhe matjen e pasurive financiare të mbajtura më 1 janar 2018 si vijon.

— Pasuritë tregtare dhe pasuritë derivative të mbajtura për administrimin e rrezikut, të cilat klasifikohen si të mbajtura për tregtim dhe të matura në FVTPL sipas SNK 39, gjithashtu do të maten në FVTPL sipas SNRF 9.

— Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët të klasifikuar si kredi dhe llogari të arkëtueshme dhe të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39 do të maten në përgjithësi me koston e amortizuar sipas SNRF 9.

— Letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim dhe të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39 o të maten në përgjithësi me koston e amortizuar sipas SNRF 9.

— Letrat me vlerë të investimit të borxhit që klasifikohen si të vlefshme për shitje sipas SNK 39, mund të maten sipas SNRF 9, me koston e amortizuar, FVOCI dhe FVTPL, varësisht nga rrethanat e veçanta.

— Huatë dhe paradhëniet për klientët dhe letrat me vlerë të investimit që janë përcaktuar si në SNKF sipas SNK 39 do të vazhdojnë të maten në FVTPL sipas SNRF 9.

Rregullimi total i parashikuar i adoptimit të SNRF 9 për Shoqërinë më 1 janar 2018 është përafërsisht 236 Euro, që paraqet:

- ✓ Një zvogëlim prej rreth 236 euro lidhur me kërkesat për zhvlerësim;
- ✓ Një ulje / rritje prej rreth 0 euro lidhur me kërkesat e klasifikimit dhe matjes, përveç dëmtimit;
- ✓ Një zvogëlim / rritje prej përafërsisht 0 euro lidhur me tatimin e shtyrë;
- ✓ Ndikime të tjera nëse ka



## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 2.4. Standardet e reja dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive (vazhdim)

#### Inputet në matjen of ECLs

Inputet kryesore në matjen e ECL-ve kanë të ngjarë të jenë struktura termike e variablave në vijim:

— PD; and

— humbja e parapare (LGD)

Vlerësimet e PD janë vlerësime në një datë të caktuar, e cila do të llogaritet në bazë të të dhënave historike të parapara sipas vlerësimit, të siguruara nga agjencitë e vlerësimit ose ofruesit e tjerë. Nëse një palë ose subjekt migron ndërmjet klasave të vlerësimit, atëherë kjo do të çojë në një ndryshim në vlerësimin e PD-së së lidhur. PD-të do të vlerësohen duke marrë parasysh maturitetet kontraktuale të subjekteve dhe normat e parashikuara të parapagimit.

LGD është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një humbje. Kompania do të vlerësojë parametrat LGD bazuar në historinë e normave të kthimit, të siguruara nga agjencitë e vlerësimit ose ofruesit e tjerë. Modelet LGD do të marrin në konsideratë strukturën dhe vjetërsinë e kërkesës.

Për portofolet në lidhje me të cilat Kompania ka të dhëna të kufizuara historike, informacion i jashtëm i referencës do të përdoret për të plotësuar të dhënat e brendshme në dispozicion. Portfoliot për të cilat informacioni i jashtëm krahasues paraqet një kontribut të rëndësishëm në matjen e ECL-ve janë si më poshtë.

Ekspozimi	Standardet e jashtme të përdorura	
	PD	LGD
E mbajtur per grumbullim	Moody's default study	Moody's default study

Sipas SNRF 9, Kompania do të inkorporojë informacione të ardhshme në të dyja vlerësimet e saj nëse rreziku i kreditit të një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe matja e ECLs.

- **SNRF 15 "Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët"** dhe ndryshimet e mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa me aksione"** - Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve"** - Zbatimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" aplikohet për herë të parë),
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë"** - Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitja ose Kontributi i Pasurive midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri kur projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit të jetë përfunduar),
- **Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 2.4. Standardet e reja dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta" - Interesat afatgjata në shoqëri dhe sipërmarrje të përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2019),
- Ndryshimet në SNK 40 "Prona e investuar" - Transferet e Pronës së Investimit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)" që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit (ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- Ndryshimet në disa standarde për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)" që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2019),
- KIRFN 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe Konsiderata paraprake" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2019).

Kompania ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde dhe ndryshime të reja të standardeve ekzistuese para datave të tyre të hyrjes në fuqi. Kompania parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit fillestar.

### 2.4. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e parasë, përfshijnë balancat me bankat për pagesat e kontribuesve pensional si dhe për qëllime të investimeve, barten në kosto.

### 2.5. Pasuritë financiare

#### Politikat e vlerësimit dhe klasifikimit

Fondi ka vendosur politikat e tij kontabël në përputhje me rregullat e BQK-së. Rregulla N.6 "Mbi Fondin Pensional dhe vlerësimin e Fondit Pensional krijon udhëzime të përgjithshme të klasifikimit dhe vlerësimit të pasurive të mbajtura nga kompanitë e pensione. Sa i përket instrumenteve financiare, neni 4.2 i Rregullores nr. 6 përcakton parimet dhe udhëzimet e mëposhtme.

- Investimet në letrat me vlerë të kapitalit janë matur me vlerën e drejtë.
- Letrat me vlera afatshkurta në vlerën e realizueshme neto, ndërsa borxhi afat-mesëm ose afat-gjatë me koston e amortizuar.
- Letrat me vlerë të Qeverisë janë matur me koston e amortizuar.
- Letrat me vlerë të blera në tregjet aktive janë vlerësuar në bazë të vlerave përkatëse të realizueshme në datën e vlerësimit.

BQK-ja mund të lejoj bazat e tjera të vlerësimit të cilat janë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare për fondet pensionale që janë të përcaktuara nga OECD ose vendet e BE-së apo të pranueshme nga SNRF.

Pas njohjes fillestare, Fondi 2 i klasifikon pasuritë financiare në kategoritë në vazhdim: në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, huatë dhe të arkëtueshmet, të mbajtura për maturim dhe të gatshme për tregtim. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin pasuritë financiare janë përvetësuar. Megjithatë, menaxhmenti i zbaton parimet e pranuar ashtu që klasifikimi duhet të jetë përgjithësisht në përputhje edhe gjatë kalimit të kohës, dhe ri klasifikimet të jenë me qëllim të përmirësimit të besueshmërisë së pasqyrave financiare.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 2.6 Pasuritë financiare (vazhdim)

#### Klasifikimi dhe riklasifikimi i instrumenteve financiare

Pas njohjes fillestare, Fondi 1 i klasifikon pasuritë financiare në kategoritë në vazhdim: në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes që përfshijnë huatë dhe të arkëtueshmet të mbajtura për maturim dhe në dispozicion për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin pasuritë financiare janë përvetësuar.

Rregulloret e BQK-së nuk kanë ndonjë rregull për riklasifikim; megjithatë, menaxhmenti i ndjek parimet e pranuar gjerësisht se klasifikimi duhet të jetë përgjithësisht i qëndrueshëm në kohë, dhe riklasifikimet janë bërë me qëllim të përmirësimit të besueshmërisë së pasqyrave financiare. Për shembull riklasifikimi i letrave me vlerë të borxhit në dispozicion për shitje e ka eliminuar paqartësitë nga rënia në vlerë e portfolin e mbajtur në maturim.

#### *Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes*

Pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë pasuri financiare në dispozicion për shitje dhe ato të përcaktuara në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në fillim. Pasuria financiare klasifikohet në këtë kategori nëse kërkohet kryesisht për qëllime të shitjes në periudhë afatshkurtër ose nëse është e përcaktuar ashtu nga menaxhmenti. Pasuritë në këtë kategori klasifikohen si pasuri qarkulluese.

#### *Huatë dhe të arkëtueshmet*

Huatë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë kuotuar në tregun aktiv. Ato janë të përfshira në pasuri qarkulluese, përveç për maturim më të gjatë se 12 muaj pas datës së pozicionit financiar. Këto klasifikohen si pasuri afatgjate. Huatë dhe të arkëtueshmet e Fondit 1 përbëjnë "të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme tjera", depozitat në banka dhe paraja dhe ekuivalentët e parasë në pozicionin financiar.

#### *Paurite financiare në dispozicion për shitje*

Paurite financiare në dispozicion për shitje jo-derivative që janë të caktuara në këtë kategori ose nuk klasifikohen në asnjë nga kategoritë e tjera. Ato përfshihen në aktivet afatgjate, përveç nëse menaxhimi synon të disponojë investimin brenda 12 muajve nga data e bilancit. Fondi 1 nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori.

#### *Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim*

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe afate të fiksuara që menaxhmenti i Fondit 1 ka qëllimin dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim. Nëse Fondi 1 do të shiste me përjashtim të një sasive të parëndësishme të aktiveve të mbajtura deri në maturim, e gjithë kategoria do të ishte e dëmtuar dhe e riklasifikuar si e mbajtur për tregtim.

#### **Njohja fillestare, matja dhe mosnjohja**

Blerjet dhe shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në datën e tregëtimit – data në të cilën Fondi 1 zotohet të blejë apo shesë pasurinë. Investimet fillimisht janë njohur në vlerën reale plus kostoja e transaksionit për të gjitha pasuritë financiare që nuk janë bartur në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Pasuritë financiare të bartura në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes fillimisht janë njohur në vlerën e drejtë dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Pasuritë financiare janë hequr kur e drejta për të pranuar rrjedhë të parase nga investimet ka skaduar ose është transferuar dhe Fondi 1 ka transferuar kryesisht të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë.

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 2.6. Pasuritë financiare (vazhdim)

#### Njohja fillestare, matja dhe mosnjohja (vazhdim)

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje (nëse janë mbajtur) dhe pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë bartur më pas në vlerë të drejtë. Huatë dhe të arkëtueshmet dhe investimet e mbajtura deri në maturim janë bartur në kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të hyrat e përcaktuara të interesit dhe amortizimi i zbritjes/(primit) janë njohur si e hyrë dhe shpenzim për periudhën.

Fitimet nga dividendat dhe fitimet apo humbjet nga ndryshimet në vlerën e drejtë të kategorisë së "pasurive financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes" janë njohur si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën ato rrjedhin.

Ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë monetare dhe jo-monetare të klasifikuara si në dispozicion për shitje (nëse janë mbajtur) janë njohur në ekuitet. Kur letrat me vlerë të klasifikuara si në dispozicion për shitje janë shitur ose dëmtuar, rregullimet e vlerës së drejtë të akumuluar që janë njohur në ekuitet janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si "fitim apo humbje nga letrat me vlerë të investimit".

Interesi mbi letrat me vlerë në dispozicion për shitje i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si pjesë e të ardhurave të tjera. Dividendat mbi instrumentët e ekuitetit në dispozicion për shitje janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si pjesë e të hyrave tjera kur është përcaktuar e drejta e Fondit 1 për të pranuar pagesat.

Vlerat reale të investimeve të kuotuar janë bazuar në çmimet aktuale të ofertimit. Nëse tregu për një pasuri financiar nuk është aktiv (dhe për letra me vlerë të pa listuara), Fondi 1 përcakton vlerën reale duke përdorur teknikat e vlerësimit.

#### Dëmtimi i pasurive financiare

Fondi 1 vlerëson në secilën datë të bilancit nëse ka dëshmi objektive se një pasuri financiare ose grup i pasurive financiare janë dëmtuar. Në rastin e letrave me vlerë të ekuitetit të klasifikuara si në dispozicion për shitje, një rënie e rëndësishme ose e tejzgjatuar në vlerën reale të letrës me vlerën nën koston e saj konsiderohet si indikator se është dëmtuar. Nëse një dëshmi e tillë ekziston për pasuritë financiare në dispozicion për shitje, humbja kumulative – e matur si ndryshim ndërmjet çmimit të përvetësimit dhe vlerës reale aktuale, minus provizioni për humbjen e dëmit mbi pasurinë financiare më parë të njohur në fitim dhe humbje – hiqet nga ekuiteti dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet e dëmtimeve të njohura në pasqyrën e të ardhurave tek instrumentët e ekuitetit nuk janë kthyer përmes pasqyrës së të ardhurave. Testimi i dëmtimit të arkëtueshmeve tregtare është përshkruar më tej në këtë shënim.

#### Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturimet fikse që menaxhmenti i Fondit 1 ka qëllim pozitiv dhe aftësi të mbajtur deri në maturim. Kur Fondi 1 ka vendosë të shesë përveç ndonjë shume të vogël të pasurive të mbajtura deri në maturim, e tërë kategoria do të priset dhe do të riklasifikohet si në dispozicion për shitje.

#### 2.7 Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet në lidhje me letrat në vlerë të investimit

Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet lindin nga blerja dhe shitja e letrave me vlerë dhe njihen si pasuri dhe/ose detyrime në datën e transaksionit të bërë.

#### 2.8 Pauritë neto të Fondit 1

Vlera neto e pasurive të Fondit 1 është barabartë me gjithsej pasuritë minus gjithsej detyrimet të Fondit 1.



## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 2.9 Vlera e njësisë së llogaritjes

Vlera e njësisë së llogaritjes barazohet me vlerën e pasurive neto të Fondit të pjestuara nga gjithsej numri i njësive të llogaritjes në datën e llogaritjes. Kjo formulë nuk aplikohet për ditën e parë të operacioneve kur vlera e njësisë së llogaritjes barazon me 100 Euro në pajtueshmëri me politikën e Fondit.

### 2.10 Të hyrat nga interesi

Të hyrat nga interesi përfshijnë të hyrat nga normat e kuponëve të obligacioneve dhe interesi mbi depozitat me afat. Të hyrat e interesit janë regjistruar në baza akruale.

### 2.11 Te hyrat nga dividenda

Dividenda njihet në pasqyrën e të ardhurave kur përcaktohet e drejta e Fondit për të marrë pagesën.

### 2.12 Tarifa e menaxhmentit

Fondi është i obliguar të paguajë tarifën e menaxhimit Kompanisë në baza ditore. Tarifa vjetore e menaxhmentit është 1.5 % të gjithsej pasurive të Fondit.

### 2.13 Shpenzimet për tarifat e transaksionit

Këto shpenzime lidhen me tarifën e paguar ndërmjetësuesve financiarë (bankave dhe komisionerëve) që sigurojnë letra me vlerë të investimeve për Fondin 1.

### 2.14 Fitimi/humbja e realizuar

Fitimet/humbjet e realizuara dalin nga shitja e letrave me vlerë, nivelizimi i çmimeve kur letrat me vlerë janë siguruar dhe kapitali i maturuar dhe interesi për letrat me vlerë janë siguruar në prime ose zbritje. Këto fitime/humbje janë regjistruar në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

Fitimet ose humbjet që rrjedhin kur investimet janë shitur ose kanë maturuar paraqiten si "të realizuara" në pasqyrën e të ardhurave, ndërsa fitimet ose humbjet që vijnë në vlerësimin e investimeve të mbajtura paraqiten veçmas si " të perealizuara" në pasqyrën e të ardhurave.

### 2.15 Amortizimi i zbritjes/primi i letrës me vlerë

Amortizimi i diskontit/primit të letrës me vlerë është regjistruar përmes të ardhurave/shpenzimeve të shtyra dhe shpenzimeve/të ardhurave akruale. Në momentin kur letra me vlerë është maturuar apo shitur, shumata e amortizuar është transferuar si fitim ose humbje e realizuar kapitale.

### 2.16 Fitimi/humbja nga këmbimi valutor

Transaksionet në valutën e huaj janë regjistruar në pajtueshmëri me normat e vlefshme të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitim/humbje.

Diferencat e këmbimit valutor që rrjedhin nga raportimi në datën vlerësimit të parasë të gatshme dhe ekuivalentëve të saj dhe diferencës që rrjedh nga shitja e investimeve raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të realizuara". Diferencat e këmbimit valutor që rrjedhin nga raportimi në datën përkthimit të investimeve të mbajtura raportohen ndaras në pasqyrën e të ardhurave si "të perealizuara".

### 2.17 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura janë definuar si ato palë të cilat kanë kontroll mbi njëra tjetrën ose kanë ose që mund të kenë ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëra tjetrës.

Palët e lidhura të Fondit janë Prva Group PLC nga Ljubljana, Sllovenia dhe Korporata Dukagjini nga Peja, Republika e Kosovës, të cilët menaxhojnë dhe administrojnë Fondin 1 dhe Kompaninë.

### 3. PASURITE E FONDIT 1 DHE STRATEGJIA E INVESTIMIT

Fondi 1 është i obliguar të ndjekë rregullat e BQK-së në lidhje me investimet në lloje të ndryshme të pasurive financiare dhe shumat e investimeve në këto pasuri.

Siç përshkruhet nga rregulla për Investimin e Pasurisë Pensionale e miratuar më 23 shkurt 2017 dhe Nenin 4 të Ligjit Nr. 05 / L-116, Rregulli 9 mbi Investimin e Pasurisë Pensionale për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04 / L-101 për fondet pensionale të Kosovës, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04 / L-115 dhe Ligjin. 04 / L-168, neni 9, neni 16 paragrafi 3 dhe neni 21 paragrafi 10 i Ligjit nr. 04 / L-101 për fondet pensionale të Kosovës, pasuese e dispozitave të Ligjit nr. 03 / L-084 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/20, Fondi 1 duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vazhdim:

- a. Fondi duhet të investojë pasuritë e tij vetëm në klasët e investimeve të lejuara (të pranueshme) të parashikuara sipas kësaj rregulle ose në para të deponuara te kujdestari ose për paratë dhe depozitat bankare që paraqesin shumat që janë arsyeshëm të nevojshme për të zhvilluar operimet e tij pensionale.
- b. Pranueshmëria e investimit përcaktohet në kohën e blërjes së tij ose përvetësimit. Nëse përcaktimi i pranueshmërisë është i bazuar në shumën, kufizimi bazohet në shumën e gjithsej pasurive të investimit sipas datës së fundit të vlersimit të pasurive, që është raportuar në BQK.
- c. Investimet e pasurive pensionale duhet të jenë në pajtueshmëri me deklaratën e parimeve të investimeve dhe konform me direktivat e investimit të përshtatura dhe të lëshuara nga entiteti i pensionit në pajtim me kërkesat e Rregullores së Pensioneve dhe këto Rregulla.
- d. Fondi i pensioneve duhet të dorëzojë raportet tremujore dhe vjetore në BQK dokumentin përmes të cilit vërtetohet se të gjitha pasuritë e pensioneve të investuara janë në përputhje me kushtet e përcaktuara me Ligjin për fondet pensionale, rregulloren, parimet e investimeve dhe direktivat e investimit të lëshuar nga fondi pensional.
- e. Investimet e pasurive pensionale duhet të ndjekë dhe të përmbushë kushtet specifike në vazhdim:
  - Përqindja maksimale e letrave me vlerë të çdo emetuesi të vetëm, duke përfshirë njësitë e tij, të cilat mund të mbahen nga Fondi i Pensioneve, është pesë përqind (5%) për stoqet dhe tridhjetë përqind (30%) për obligacionet. Asnjë kufizim i tillë nuk do të aplikohet për Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës.
  - Përqindja maksimale e totalit të mjeteve pensionale që mund të investohen në pasuritë e çdo emetuesi të vetëm, duke përfshirë llogaritjen e pasurive të njëjësive të anëtarësuar, zbatohet në përputhje me nenin 4 të Ligjit nr. 05 / L-116 për ndryshimin dhe duke plotësuar Ligjin nr. 04 / L-101 për fondet pensionale të Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04 / L-115 dhe Ligjit. 04 / L-168.
- f. Duke ndryshuar këtë rregullore, BQK-ja mund të përcaktojë periodikisht vlerat minimale të investimit për çdo klasë të asetëve:

*Investimet e pranueshme të mjeteve të pensionit*

Pasuritë e fondit pensional mund të investohen vetëm në klasat ndërkombëtare si në vazhdim:

- a. Fondet monetare, përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat me banka që janë të licensuara nga autoriteti rregullativ banker i një shteti anëtar i OECD-së, dhe licenca e të cilit mbetet në fuqi dhe gjendje të mire;
- b. Letrat me vlerë të lëshuara nga ndonjë shtet anëtar i OECD-së;
- c. Letrat me vlerë të lëshuara nga qeveritë vendore në shtetet anëtare të OECD-së në atë masë që të jenë të garantuara nga shteti përkatës;
- d. Letrat me vlerë të regjistruara me rregullatorin e tregjeve kapitale të ndonjë shteti anëtar të OECD-së dhe të vendosura për ofertë publike dhe aktivisht të listuara dhe tregtuara në Bursën e Aksioneve që në shtetet e tilla është rregulluar dhe mbikqyrë në mënyrë përkatëse;
- e. Fondet e ndërsjella dhe ato të investimeve që i nënshtrohen miratimit në shtetin e themelimit, një shtet që është anëtar i OECD.

### 3. PASURITE E FONDIT 1 DHE STRATEGJIA E INVESTIMIT (VAZHDIM)

*Letrat me vlerë të lëshuara dhe/ose të lokalizuara në Republikën e Kosovës*

- a. Fondet monetare, duke përfshirë llogari bankare dhe depozitat në banka që janë të licensuara nga BQK dhe që zhvillojnë biznes ndërkombëtarë në Republikën e Kosovës në raport të mirë me kërkesat rregullative të BQK-së.
- b. Letrat me vlerë të lëshuara nga autoriteti kompetent në Republikën e Kosovës;
- c. Letrat me vlerë të lëshuara nga ndërmarrjet publike dhe/ose private që janë regjistruar në rregullatorin e tregjeve kapitale në Kosovë duke siguruar se fondet e tilla janë të listuara dhe tregtuar në bursën(at) e letrave me vlerë të listuara në republikën e Kosovës ose në një vend anëtar të OECD-së dhe që janë subjekt të rregullimit dhe mbikqyrjës nga autoriteti i tregut kapital në atë shtet;
- d. Fondet e ndërsjellta dhe fondet e tjera të ndërsjellta (entitet "Subjekte të hapura") që janë subjekte të aprovimit në Kosovë dhe për të cilat kërkesat e përshtatshmërisë janë përshkruar nga autoriteti rregullator dhe mbikqyrës përkatës në Republikën e Kosovës në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve biznesore të entiteteve të tilla "Subjekte të hapura";

Fondi 1 duhet gjithashtu të jetë në pajtueshmëri me rregullën mbi investimet e ndaluara të cilat definojnë si më poshtë:

Pasuritë pensionale nuk mund të investohen në llojet në vazhdim:

- e. instrumentet e letrave me vlerë të cilat nuk janë të regjistruara ose nuk tregtohen publikisht; asetet që nuk janë në gjendje të tjetërsojnë me ligj;
- f. instrumentet e letrave me vlerë, opsionet, të ardhmurat, marrëveshjet e ardhshme dhe të tjera në lidhje me letrat me vlerë dhe aktivet e tjera financiare, përveç se derivativët mund të përdoren si një strategji mbrojtëse për të zvogëluar rrezikun, me kusht që Trusti të mos ketë pozitë shitjeje të zbuluar;
- g. pasuritë e paluajtshme ose asetet fizike që nuk janë të listuara në tregjet e organizuara për të cilat vlerësimi është i pasigurt, duke përfshirë antikikat, veprat e artit, monedhat dhe mjetet motorike dhe tëngjashme;
- h. çdo pasuri e Menaxherit të Aseteve ose Kujdestarit të fondit ose anëtarit të Bordit Drejtues të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ose ndonjë Subjekti të Anëtarësuar të Menaxherit të Aseteve, Kujdestarit ose anëtarit të Bordit Drejtues të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;
- i. letrat me vlerë të lëshuara nga Subjekti i Anëtarësuar sipas Nenit 2 të kësaj Rregulloreje;
- j. fonde të tjera të përcaktuara nga BQK-ja. Letrat me vlerë të llojeve që nuk janë të lejuara me rregulloren e pensioneve, këtë rregull dhe/ose letrat me vlerë të siguruara e që nuk janë në pajtim me principet e investimit dhe direktivat e entitetit të pensionit në kohën e përvetësimit të tyre.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI  
SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1  
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**4. INSTRUMENTET FINANCIARE SIPAR KATEGORISË**

Vlerat bartëse të pasurive financiare dhe detyrimeve të Kompanisë siç janë njohur në datën e pasqyrave financiare nën rishikim mund të kategorizohen siç vijon:

	Në vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes	Huatë dhe të arkëtueshmet	Të mbajtura deri në maturim	Gjithsej
<b>31 dhjetor 2017</b>				
<b>Pasuritë</b>				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	162,531	-	162,531
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	6,621,550	-	-	6,621,550
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	230,927	230,927
Të arkëtueshme të tjera	-	2,290	-	2,290
<b>Gjithsej</b>	<b>6,621,550</b>	<b>164,821</b>	<b>230,927</b>	<b>7,017,298</b>
<b>Detyrimet tjera financiare me kosto të amortizuar</b>				
<b>Detyrimet</b>				<b>Gjithsej</b>
Detyrimet për taksën e menaxhimit	-	-	10,748	10,748
Detyrimet të tjera	-	-	84,850	84,850
<b>Gjithsej</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>95,598</b>	<b>95,598</b>
<b>31 December 2016</b>				
<b>Pasuritë</b>				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	66,854	-	66,854
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	6,230,200	-	-	6,230,200
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	190,308	190,308
Të arkëtueshme të tjera	-	3,328	-	3,328
<b>Gjithsej</b>	<b>6,230,200</b>	<b>70,182</b>	<b>190,308</b>	<b>6,490,690</b>
<b>Detyrimet tjera financiare me kosto të amortizuar</b>				
<b>Detyrimet</b>				<b>Gjithsej</b>
Detyrimet për taksën e menaxhimit	-	-	9,716	9,716
Detyrimet të tjera	-	-	996	996
<b>Gjithsej</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>10,712</b>	<b>10,712</b>



**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI  
SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1  
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**5. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ**

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogaria rrjedhëse - ABANKA - EUR	105,210	15,770
Llogaria rrjedhëse - BKT	6,525	1,719
Llogaria e kursimeve - Raiffeisen Bank	20,944	21,245
Llogaria e kontributeve – NLB Kasabank	6,232	666
Llogaria e parasë së gatshme - TEB	147	7,099
Llogaria e kontributeve – Pro Credit Bank	325	1,291
ABANKA - Llogaria rrjedhëse - USD	15,176	12,410
Llogaria e kontributeve – Banka Ekonomike	7,943	6,620
Banka Ekonomike	29	34
<b>Gjithsej</b>	<b>162,531</b>	<b>66,854</b>

**6. LETRAT ME VLERË NË DISPOZICION PËR SHITJE**

Investimet në dispozicion për shitje në deklaratën e pozicionit financiar janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Obligacionet e korporatave	925,904	1,503,149
Obligacionet qeveritare	773,614	1,047,351
Letra me vlerë ekuiteti	4,822,625	3,630,076
Letrat komerciale	99,407	49,624
<b>Gjithsej</b>	<b>6,621,550</b>	<b>6,230,200</b>

Tabela ne vazhdim paraqet lëvizjen e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim gjatë vitit 2017 and 2016:

	Obligacionet		Letrat më		
	e korporatave	Obligacionet Qeveritare	Letrat komerciale	vlerë ekuiteti	Gjithsej
<b>Më 01 janar 2017</b>	<b>1,503,149</b>	<b>1,047,351</b>	<b>49,624</b>	<b>3,630,076</b>	<b>6,230,200</b>
Shtesat	42,522	239,317	132,411	1,069,557	1,483,807
Shitje/maturim	(634,757)	(500,906)	(83,220)	(187,077)	(1,405,960)
Ndryshimi neto në kursin valutor	-	-	-	(286,671)	(286,671)
Fitimi/humbja e porealizuar	14,990	(12,148)	592	596,740	600,174
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>925,904</b>	<b>773,614</b>	<b>99,407</b>	<b>4,822,625</b>	<b>6,621,550</b>
<b>Më 01 janar 2016</b>	<b>1,773,790</b>	<b>1,686,302</b>	<b>90,990</b>	<b>1,595,842</b>	<b>5,146,924</b>
Shtesat	93,079	182,835	49,131	1,681,153	2,006,198
Shitje/maturim	(465,562)	(867,032)	(90,990)	-	(1,423,584)
Ndryshimi neto në kursin valutor	-	-	-	85,492	85,492
Fitimi/humbja e porealizuar	101,842	45,246	493	267,589	415,170
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,503,149</b>	<b>1,047,351</b>	<b>49,624</b>	<b>3,630,076</b>	<b>6,230,200</b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI  
SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1**

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**7. INVESTIMET E MBAJTURA DERI NË MATURIM**

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim përbëjnë tërësisht obligacionet dhe letrat tjera me vlerë të borxhit të emetuara nga kompanitë e huaja dhe bankat.

	<u>31 December 2017</u>	<u>31 December 2016</u>
Depozitat në banka	229,000	189,000
Interesi i përllogaritur (akruar)	1,927	1,308
<b>Gjithsej</b>	<b><u>230,927</u></b>	<b><u>190,308</u></b>

Depozitat në banka dhe interesi i përllogaritur është si vijon:

	<u>31 December 2017</u>	<u>31 December 2016</u>
Banka Kombetare Tregtare BKT	230,927	190,308
	<b><u>230,927</u></b>	<b><u>190,308</u></b>

Depozitat në banka fitojnë interes prej 1.4% deri 3% në baza vjetore. Periudha e maturimit të tyre varion nga 2 deri 5 vjet.

**8. DETYRIMET PËR NDARJEN E FITIMIT**

Kompania ka shpërblyer menaxherin e pasurive në baze të planit pensional "Në rast se fondi performon më mirë se sa kufiri i përcaktuar në aktin e brendshëm atëherë menaxheri i pasurive ka të drejtë të shpërblehet deri në 20% të mbikufirit të të ardhurave".

Kthimi i Fondit është themeluar çdo vit më 30 nëntor, periudha kontabël është një vit. Plani pensional i kompanisë për kthimin e fondeve është miratuar nga Banka Qëndrore.

**9. TË HYRAT NGA INTERESI**

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Të hyrat nga interesi i letrave me vlerë	74,980	107,718
Të hyrat nga interesi në depozita	5,904	6,776
Të hyrat nga interesi në llogari bankare	1	2
<b>Gjithsej</b>	<b><u>80,885</u></b>	<b><u>114,496</u></b>

**10. FITIMI I REALIZUAR NGA SHITJA/MATURIMI I INVESTIMEVE NË LETRA ME VLERË**

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Obligacionet qeveritare	33,206	11,766
Obligacionet e korporatave	13,410	11,893
Letrat komerciale	780	1,010
<b>Gjithsej</b>	<b><u>47,396</u></b>	<b><u>24,669</u></b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI  
SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1**

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**11. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA**

Palët e lidhura përfshijnë aksionarët kryesorë, bashkimet dhe entitetet nën pronësi të përbashkët, kontrollin dhe menaxhimin e Fondit, apo aktivitetet e të cilave Fondi ka kompetencën për ti kontrolluar.

Të gjitha transaksionet e Fondit me palët e lidhura dalin nga rrjedha normale e biznesit dhe vlera e tyre nuk është materialisht e ndryshe nga afatet dhe kushtet që do të i zotëronin në transaksione të vullnetit të lirë. Të gjitha transaksionet e palëve të lidhura dhe balancet i referohen Kompanisë, FSKP-së dhe janë si në vazhdim:

31 Dhjetor 2017	Prva Group	Kompania	Fond 2	Gjithsej
<b>Të arkëtueshmet</b>				
Të arkëtueshmet nga Kompania	-	389	-	389
<b>Gjithsej të arkëtueshmet</b>	-	<b>389</b>	-	<b>389</b>
<b>Detyrimet</b>				
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	10,748	-	10,748
<b>Gjithsej Detyrimet</b>	-	<b>10,748</b>	-	<b>10,748</b>
<b>Të arkëtueshmet neto/(detyrimet)</b>	-	<b>(10,359)</b>	-	<b>(10,359)</b>
<b>Shpenzimet</b>				
Shpenzimet për ndarjen e fitimit	77,653	-	-	77,653
Shpenzimet për tarifën e menaxhimit	-	101,879	-	101,879
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>77,653</b>	<b>101,879</b>	-	<b>179,532</b>
<b>Neto e ardhura/(shpenzimet)</b>	<b>(77,653)</b>	<b>(101,879)</b>	-	<b>(179,532)</b>

FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI  
SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1  
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

11. TRANSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

31 Dhjetor 2016	Prva Group	Kompania	Fondi 2	Gjithsej
<b>Të arkëtueshmet</b>				
Të arkëtueshmet nga Kompania	-	175	110	285
<b>Gjithsej të arkëtueshmet</b>	-	<b>175</b>	<b>110</b>	<b>285</b>
<b>Detyrimet</b>				
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	9,716	-	9,716
<b>Gjithsej detyrimet</b>	-	<b>9,716</b>	-	<b>9,716</b>
<b>Të arkëtueshmet neto/(detyrimet)</b>	-	<b>(9,541)</b>	<b>110</b>	<b>(9,431)</b>
<b>Shpenzimet</b>				
Shpenzimet për ndarjen e fitimit				
Shpenzimet për tarifën e menaxhimit	45,779	-	-	45,779
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	-	<b>108,401</b>	-	<b>108,401</b>
	<b>45,779</b>	<b>108,401</b>	-	<b>154,180</b>
<b>Neto e ardhura/(shpenzimet)</b>	<b>(45,779)</b>	<b>(108,401)</b>	-	<b>(154,180)</b>

## 12. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj disa risqeve financiare dhe këto aktivitetet përfshijnë analizat, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e risqeve. Synimi i Fondit është që të arrijë një balancë të përshtatshëm ndërmjet riskut dhe kthimit dhe të minimizojë kundër efektet e mundshme mbi performancën financiare të Fondit.

Politikat e Fondit për menaxhimin e riskut janë dizajnuar për të identifikuar dhe analizuar këto risqe, për të vënë limitet e duhura dhe kontrole të riskut, dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve me anë të mjeteve të sistemit informative të besueshëm dhe modern. Menaxhmenti i Fondit rregullisht rishikon politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut për të reflektuar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikatat më të mira që dalin.

Menaxhimi i riskut bartet nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut nën politikat e aprovuara nga Kompania. Ky departament identifikon dhe vlerëson riskun financiar në bashkpunim të ngushtë me njësitë operative të Fondit. Fondi ofron parime të shkruara për menaxhimin e përgjithshëm të riskut, si dhe politika të shkruara që mbulojnë fusha specifike, si risku i këmbimeve të huaja, risku i normës së interesit dhe risku kreditor.

### *Risku kreditor*

Fondi merr pjesë në ekspozimin ndaj riskut kreditor, i cili është një rrezik që një palë e kundërt do të shkaktojë humbje për Fondin duke dështuar në shlyerjen e obligimit. Risku kreditor është risku më i rëndësishëm për aktivitetet biznesore të Fondit. Prandaj, menaxhmenti i Fondit me kujdes menaxhon ekspozimin ndaj riskut kreditor. Fondi duhet të jetë në përputhje me rregullat e BQK-së përsa i përket llojeve dhe shumave të investimeve në pasuritë financiare

	2017	2016
<b>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë</b>		
<b>Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim</b>		
Obligacionet e korporatave	925,904	1,503,149
Obligacionet e korporatave	773,614	1,047,351
Letrat me vlerë të ekuitetit	4,822,625	3,630,076
Faturat komerciale	99,407	49,624
	<b>6,621,550</b>	<b>6,230,200</b>
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim		
Depozitat në banka	229,000	189,000
Interesi i përllogaritur (akruar)	1,927	1,308
<b>Gjithsej</b>	<b>230,927</b>	<b>190,308</b>
	2,290	3,328
Të arkëtueshmet tjera	<b>6,854,767</b>	<b>6,423,836</b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**12. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

*Rreziku i normës së interest*

Tabela e mëposhtme analizon pasuritë dhe detyrimet e Fondit në grupime relevante të maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur në datën e pozicionit financiar deri te data e maturimit të kontraktuar, për 31 dhjetor 2017 dhe 2016 (në Euro).

	Që bartin interes						
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Gjithsej
<b>31 Dhjetor 2017</b>							
<i>Pasuritë</i>							
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	162,531	-	-	-	-	-	162,531
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	-	246,625	1,201,123	350,940	4,822,862	6,621,550
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	29,452	201,476	-	-	230,927
Të arkëtueshmet tjera	-	-	-	-	-	2,290	2,290
	<b>162,531</b>	<b>-</b>	<b>276,077</b>	<b>1,402,599</b>	<b>350,940</b>	<b>4,825,152</b>	<b>7,017,298</b>
<i>Detyrimet</i>							
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	-	-	-	-	10,748	10,748
Detyrimet për ndarjen e fitimit	-	-	-	-	-	77,653	77,653
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	7,197	7,197
	-	-	-	-	-	<b>95,598</b>	<b>95,598</b>
<b>Hendeku në neto riskun e interesit</b>	<b>162,531</b>	<b>-</b>	<b>276,077</b>	<b>1,402,599</b>	<b>350,940</b>	<b>4,729,554</b>	<b>6,921,700</b>
<b>31 December 2016</b>							
Pasuritë	66,854	274,613	425,119	1,521,734	568,966	3,633,404	6,490,690
Detyrimet	-	-	-	-	-	10,712	10,712
<b>Hendeku në neto riskun e interesit</b>	<b>66,854</b>	<b>274,613</b>	<b>425,119</b>	<b>1,521,734</b>	<b>568,966</b>	<b>3,622,692</b>	<b>6,479,978</b>



**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI  
SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1**

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**12. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

*Risku i valutës së huaj*

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Fond 1 është ekspozuar riskut duke marrë parasysht efektet nga rrjedha e parasë të normës së nivelit të këmbimit valuator. Tabelat në vijim përmbledhin pozicionin e riskut valuator të pasurive monetare dhe detyrimeve të Fondit më 31 Dhjetor 2017 and 2016 (në Euro):

31 December 2017	In EUR	in USD	Other	Total
<b>Pasuritë</b>				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	147,356	15,175	-	162,531
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	3,815,701	2,805,849	-	6,621,550
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	230,927	-	-	230,927
Të arkëtueshmet tjera	2,290	-	-	2,290
<b>Gjithsej pasuritë</b>	<b>4,196,274</b>	<b>2,821,024</b>	-	<b>7,017,298</b>
<b>Detyrimet</b>				
Detyrime për tarifat e menaxhimit	10,748	-	-	10,748
Detyrime për ndarjen e fitimit	77,653	-	-	77,653
Detyrime të tjera	7,197	-	-	7,197
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>95,598</b>	-	-	<b>95,598</b>
<b>Risku i valutës së huaj neto</b>	<b>4,100,676</b>	<b>2,821,024</b>	-	<b>6,921,700</b>
<b>31 Dhjetor 2016</b>				
Gjithsej pasuritë	4,093,391	2,397,299	-	6,490,690
Gjithsej detyrimet	10,712	-	-	10,712
<b>Risku i valutës së huaj neto</b>	<b>4,082,679</b>	<b>2,397,299</b>	-	<b>6,479,978</b>

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**12. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

*Liquidity risk*

Politika e Fondit 1 është të investojë pasuritë në instrumentet e larta likuide financiare në tregje të ndryshme kapitale në përputhshmëri me kufizimet e përshkruara nga Ligji dhe Rregulloret. Gjatë procesit të krijimit të portfolios së Fondit, duke u munduar të sigurojmë likuiditet të lartë, pasuritë e Fondit janë investuar në letra me vlerë të karakterizuara me mundësinë e shkëmbimit të shpejtë në para dhe ekuivalente të parasë.

Tabela në vazhdim analizon pasuritë dhe detyrimet e Fondit në maturim relevant duke u bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit të gjendjes deri në datën e kontraktuar të maturimit (në Euro).

31 Dhjetor 2017	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Gjithsej
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	162,531	-	-	-	-	162,531
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	-	-	246,625	1,201,123	5,173,802	6,621,550
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	29,452	201,476	-	230,928
Të arkëtueshmet tjera	2,290	-	-	-	-	2,290
	<b>164,821</b>	<b>-</b>	<b>276,077</b>	<b>1,402,599</b>	<b>5,173,802</b>	<b>7,017,299</b>
<i>Detyrimet</i>						
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	10,748	-	-	-	-	10,748
Detyrimet për ndarjen e fitimit	77,653	-	-	-	-	77,653
Detyrimet tjera	7,197	-	-	-	-	7,197
	<b>95,598</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>95,598</b>
<b>Hendeku i neto likuiditetit</b>	<b>69,223</b>	<b>-</b>	<b>276,077</b>	<b>1,402,599</b>	<b>5,173,802</b>	<b>6,921,701</b>
<b>31 Dhjetor 2016</b>						
Gjithsej pasuritë	70,182	274,613	425,119	1,521,734	4,199,042	6,490,690
Gjithsej detyrimet	10,712	-	-	-	-	10,712
<b>Hendeku i neto likuiditetit</b>	<b>59,470</b>	<b>274,613</b>	<b>425,119</b>	<b>1,521,734</b>	<b>4,199,042</b>	<b>6,479,978</b>

**13. VLERA E DREJTË**

Vlera e drejtë përfaqëson shumën me të cilën një pasuri mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në transaksion duar lirë. Vlera e drejtë është bazuar në supozimet e menaxhmentit sipas fitimit të pasurisë dhe bazës së detyrimit.

*Instrumentet financiare të prezentuara me vlerën e drejtë*

Pasuritë financiare të llogaritura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhshmëri me hierarkinë e vlerës së drejtë janë të paraqitura në tabelën vijuese. Kjo hierarki mbledh pasuritë financiare dhe detyrimet në tri nivele që bazohen në rëndësinë e të dhënave të ardhura të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuritë identike ose detyrimet;
- **Niveli 2:** të dhëna hyrëse të tjera, përveç prej, çmimeve të kuotuar, të përfshira në nivelin 1 që janë të gatshme për vëzhgim të pasurisë ose të detyrimit, direkt (p.sh. si çmime), ose indirekt (p.sh. të bëra nga çmimet) dhe;
- **Niveli 3:** të dhënat hyrëse në pasuri ose detyrim që nuk janë të bazuara në të dhëna të gatshme për vëzhgim të tregut.

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - FONDI SHENIMET PER PASQYRAT FINANCIARE TE FONDIT 1**  
**Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

*(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)*

**13. VLERA E DREJTË (VAZHDIM)**

The financial assets that are measured at fair values in The Statement of Fund 1's Net Assets are grouped according to the hierarchy level of the fair value, as follows (in Euro).

**31 Dhjetor 2017**

Pasuritë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	5,992,824	628,726	-	6,621,550
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	230,927	-	230,927

**31 Dhjetor 2016**

Pasuritë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Letrat me vlerë në dispozicion për shitje	5,308,375	921,825	-	6,230,200
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	190,308	-	190,308

Tabela në vijim përmbledh vlerat bartëse dhe vlerën e drejtë të atyre pasurive financiare dhe detyrimeve që nuk janë prezentuar në pozicionin financiar tek vlera e drejtë.

Pasuritë	Vlera bartëse		Vlera e drejtë	
	2017	2016	2017	2016
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	162,531	66,854	162,531	66,854
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	230,927	190,308	230,927	190,308
Të arkëtueshme të tjera	2,290	3,328	2,290	3,328
<b>Gjithsej pasuritë</b>	<b>395,748</b>	<b>260,490</b>	<b>395,748</b>	<b>260,490</b>

**Detyrimet**

Detyrimet për tarifën e menaxhimit dhe detyrime të tjera	95,598	10,712	95,598	10,712
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>95,598</b>	<b>10,712</b>	<b>95,598</b>	<b>10,712</b>

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në tregje aktive (siq janë letrat me vlerë të tregtueshme dhe në dispozicion për shitje) është e bazuar në çmimet e kuotuar të tregut në datën e pozicionit. Çmimi i kuotuar i tregut i përdorur për pasuritë financiare të mbajtura nga Fondi është çmimi aktual i ofertimit.

Vlera reale e instrumenteve financiare që nuk janë tregtuar në tregje aktive është përcaktuar duke përdorur teknikat e vlerësimit.

Vlerat bartëse minus provisioni për dëmtimin e të arkëtueshmeve tregtare si dhe vlera bartëse e të pagueshmeve supozohet se përfaqëson vlerat e tyre reale. Vlera reale e detyrimeve financiare për qëllime të shpalosjes është vlerësuar duke zbritur rrjedhat e ardhshme të parasë së kontraktuar në normën e interesit aktuale në treg që është në dispozicion të fondit për instrumente të ngjashme financiare. Megjithatë, për vendosjet bankare afatshkurtra ku normat e interesit janë të krahasueshme në treg, vlera kontabël është konsideruar të jetë përfaqësi më e mirë e vlerës së drejtë.

**14. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Pas 31 dhjetor 2017 - datën e raportimit, deri në miratimin e këtyre raporteve financiare, nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare apo ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për shpalosjen e këtyre pasqyrave financiare.